kali i kish rënë me shkelmë. Fytyra e tij e zeshkë dhe mjekrën e ka të pa rojur; kopsat e pandallonave të pa mbërthyra. Ka një vështrim "vague" i cili të kail frikën. Eshtë Zadrimas, grindavec, dhe e quhajnë Zef.

N'Ungrej ndenjmë disa dit dhe në këtë kohë Amerikani ma te burrat e dheut. Marku dita me ditën përmirësonte kujdesjet e tija dhe nuk ndjemë as pak se ndodheshim në Mirditë. Për kohë na pruri edhe birë nga Leshi!

"Të vini të mateni!", ish urdhër'i Kryetarit e Komunës s'Ungrejt i cili na u komunikoj q'e që ishin rreth e përqark fshatit. Këto njerëz nuk kishin as një kuptim për ta. Të mateni, përse? kush e do? Qeveria? përse? për ushtarë? për taksa? për punë? Pa me dyshim na vinin për t'u matur burrat e dheut, disa nga të cilët kishilloheshin me njëri jatrin më parë se t' i hynin valles.

Ditën e treté, midis burrave të tjerë, na erdhi edhe një nga të parët e katundit Rras. Passi u mat mirë mirë, i thamë se do vinim në shtëpin' e tij për të mbledhur disa burra të fshatit të vet. "Të urdhnoni! Të urdhnoni!" na thotë miku i mirë dhe gaz' i math tregoheshe në syt e tij.

Të nesërmet u nismë për në Rras ku arrimë pas no një orë udhëtimi dhe dyke shkuar në-